



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.732/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Afijete Sada - Glllogjani, Ferki Xhaferi, anëtar duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtime Përparim Ramusa nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Shtime, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.732/2021 i datës 03.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Shtime Përparim Ramusa, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Shtime, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 me të cilin ka kërkuar korrigjimin e votave në vendvotimin 22008E/01D.

## A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.732/2021, të paraqitur nga Përparim Ramusa Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilin pretendon se në vendvotimin 22008/E/01D, në Davidovc, ka mospërputhje të rezultateve. Në atë vendvotim kam marrë 39 vota, kurse në FRP janë vendosur vetëm 9 vota. Si dëshmi ka ofruar Fletën Llogaritëse të votave për Kandidatët në atë vendvotim, si dhe fletën llogaritëse të vëzhguesit si dhe fletën e rezultateve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Përparim Ramusa , kërkon korrigjimin e votave në vendvotimin 22008E/01D. PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Përparim Ramusa Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilin kërkon që ti korrigjohen votat sepse pretendon se i ka 39 vota dhe jo 9 vota sa janë në formular, është i pa bazuar, sepse parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete dhe si të tilla vlerësohen si pretendime të pa bazuara, ngase, nga formularët që janë bashkangjitur apelit, Fleta llogaritëse për votat e kandidatëve dhe Formulari i Rezultateve të kandidatëve, rezulton se nuk ka asnjë paqartësi në bartjen e votave dhe se votat në të dy këta formular janë të njëjta pra gjithsej 9 vota dhe jo ashtu siç pretendon parashtuesi i apelit 39 vota. Për më tepër paneli vlerëson se nuk është bazë mjaftueshme për rinumërimin e asnjë vendvotimit vetëm pse kandidati jeton në fshatin ku gjendet vendvotimi rezultatit i të cilit është ankimuar, ku pritjet e kandidatit lëndor kanë qenë më te larta.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtuar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin ankues.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.732/2021 më datën 04.11.2021**

**Kryesues i Panelit  
Adnan Konushevc**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.